

VENDIM
Nr. 28, datë 17.1.2018

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË BORDIT TË MENAXHIMIT TË AUTORITETIT
RRUGOR SHQIPTAR**

*(Ndryshuar me VKM nr. 21, datë 16.1.2019; nr. 455, datë 29.6.2022; nr. 79, datë 14.2.2024; nr. 137, datë 6.3.2025;
nr. 287, datë 28.5.2025)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 10164, datë 15.10.2009, “Për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar, i cili do të kryesohet nga *Ernal Nufi, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë*, dhe në përbërje të tij të ketë këta anëtarë, përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

- a) Z. Sokol Ismaili, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;*
- b) Z. Renald Petriri, Ministria e Financave;*
- c) Z. Stiljan Llavdaniti, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor;*
- ç) Z. Luigj Aleksi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (riemërim);*
- d) Z. Haqbi Parllaku, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë;*
- dh) Z. Gëzim Beqaj, Shoqata Shqiptare e Inxhinierëve Konsulentë.*

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet e planifikuara për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

3. Vendimi nr. 1010, datë 13.11.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të bordit të menaxhimit për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama